



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME
Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport



RREGULLORE
KOMUNALE PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË

Maj, 2023



Npi – 01/209 datë: 31.05.2023

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi (c) si dhe nenin 17 paragrafi (h), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, Statutit të Komunës, si dhe Rregulloren Komunale për Institucionet edukativo-arsimore 01Nr.06/1795-200, dt.15.09.2010, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -V- të rregullt të mbajtur më: 31.05.2023 miratoi këtë:

RREGULLOREN KOMUNALE PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet për aplikim, kriteret, kohëzgjatja e realizimit të bursës, lartësia e bursës, procedurat e përzgjedhjes së përfituesve të bursave, formimi i komisionit dhe e drejta e ankesës.

Neni 2

- 2.1. Lartësia e bursës është 50 euro për një muaj.
- 2.2. Kuvendi me vendim cakton sasinë e bursave për vitin akademik, sipas drejtimeve prioritare (deficitare) fakulteteve të cilat i propozon-cakton DKA.
- 2.3. Bursat ndahen për 10 muaj, (për periudhën kohore 1 Tetor deri 31 korrik të vitit vijues Akademik).
- 2.4. Bursat që u jepen studentëve, konsiderohen ndihmë për shkollim nga Komuna dhe Studentët përfitues nuk kanë obligime për kthimin e tyre.

Neni 3

Të gjithë studentët, banorë të komunës së Shtimes, pa kurrfarë dallimesh etnike, gjinore, racore, fetare dhe politike të cilët janë studentë të rregullt, apo kanë regjistruar ndonjë fakultet në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit publik dhe bartësit tjerë të arsimit të lartë në Kosovë, dhe jashtë vendit, që janë të akredituar me përjashtim të studimeve master dhe post-diplomike, kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave për studentë.

II. SIGURIMI DHE SHFRYTËZIMI I MJETEVE

Neni 4

Mjetet për bursa sigurohen nga buxheti i Komunës së Shtimes dhe nga donatorët (nëse paraqitet ndonjë vullnetar).

Neni 5

- 5.1. Kuvendi i Komunës në bazë të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës dhe eventualisht të ndonjë donatori vullnetar për ç' do vit cakton numrin dhe shumën e bursës.
- 5.2. Kuvendi me vendim cakton sasinë e bursave për vitin akademik, sipas drejtimeve prioritare (deficitare) fakulteteve të cilat i propozon-cakton DKA.
- 5.3. Bursat jepen prej vitit të dytë të studimeve,
- 5.4. Nëse nuk plotësohet numri, bursa u ndahen edhe studentëve të vitit të parë,

Neni 6

- 6.1. Një student nuk ka të drejtë të marrë dy apo më shumë bursa nga njësitë buxhetore apo burime të ndryshme,
- 6.2. Nëse vërtetohet se studenti që është përfitues i bursës nga Komuna është duke marrë bursë edhe nga ndonjë njësi tjetër buxhetore ai obligohet ta kthejë bursën e Komunës.

Neni 7

- 7.1. Prej një familje mund të marrë bursë vetëm një student.
- 7.2. Nëse familja ka dy e më shumë studentë që i plotësojnë kushtet për përfitimin e bursës, do ta përfitojë bursën studenti që ka notë mesatare më të lartë.

III. KUSHTET PËR APLIKIM

Neni 8

Të drejtën për të aplikuar për bursë e kanë të gjithë studentët, sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje të cilët:

- a) janë banorë rezidentë të Komunës së Shtimes,
- b) janë studentë të rregullt në ndonjërin nga fakultetet që ofrohet nga bartësit publik dhe bartësit tjerë të arsimit të lartë në Kosovë dhe jashtë vendit që janë të akredituar,
- c) kanë të dhëna të gjitha provimet e vitit paraprak,
- d) nuk janë përsëritës të vitit të studimeve,
- e) kanë notën mesatare 7 (shtatë) e më të lartë,

IV. KRITERET PËR PËRZGJEDHJE

Neni 9

- 9.1. Fëmijëve të dëshmorëve u ndahen bursat me automatizëm që nga viti i parë i studimeve, por në rast të përsëritjes së viti, studenti e humb të drejtën për bursë, të drejtën në bursë studenti përsëri mund ta shfrytëzon vetëm pas dorëzimit të dëshmisë, për regjistrimin e vitit vijues të studimeve, në të njëjtin fakultet.
- 9.2. Vlerësimi kandidatëve bëhet me pikë,
- 9.3. Përzgjedhja e fituesve të bursës bëhet sipas renditjes së notës më të lartë mesatare, duke e shumëzuar notën mesatare me koeficientin 10%, për kategoritë që lirohen sipas Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba, për familjen e ngushtë.
- a) Studenti i Invalidëve të luftës,
- b) Studenti i Veteranëve të luftës,
- c) Studenti i Martirit të luftës,
- d) Studenti me gjendje të rëndë sociale,

- e) Studenti që është me aftësi të kufizuara,
- f) Studenti pa prind ose në mbikëqyrje të nënës,
- g) Studenti i Prindit të burgosur politik,
- h) Studenti që ka fituar shpërblim kombëtar ose ndërkombëtar në lëmin e arsimit.

V. KONKURSI

Neni 10

10.1. Bursat ndahen në bazë të konkursit publik.

10.2. Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport bënë shpalljen e konkursit publik në tabelën e publikimeve pranë Komunës së Shtimes, në Web- faqen e Komunës dhe në mediet lokale.

10.3. Konkursi duhet të përmbajë:

- a) kushtet për konkurrim,
- b) shumën e bursës për një vit kalendarik,
- c) dokumentet e nevojshme për konkurrim,
- d) profilet prioritare (deficitare), numri i bursave sipas fakulteteve përkatëse të përcaktuara me nenin 2.2.
- e) afati për aplikim është 15 ditë kalendarike.

Neni 11

11.1. Marrja dhe dorëzimi aplikacioneve bëhet në Drejtorinë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, respektivisht në zyre përkatëse të kësaj drejtorie.

11.2. Zyrtari që bënë pranimin e aplikacioneve duhet:

- a) të kontrollojë dokumentet e aplikimit nëse janë apo nuk janë të kompletuara,
- b) të regjistrojë dokumentet që i bashkëngjiten aplikacionit,
- c) të vërtetojë se a është fotokopja e indeksit identike me origjinalin.

Neni 12

12.1. Dokumentet e nevojshme për konkurrim:

- a) certifikata e provimeve të dhëna së bashku me fotokopjen e indeksit,
- b) deklaratë e bashkësisë familjare,
- c) dëshmia se është invalid i luftës, se është fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, se është person me aftësi të kufizuara dhe se është nga familja në skemën sociale,
- d) Dëshmi se është student i prindit ish i burgosur politik.
- e) certifikatën e vendbanimit,
- f) diplomat, mirënjohjet, certifikatat për suksesin e arritur në gara-kurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin arsimor.

12.2. Studentët që janë invalid të luftës, anëtar të familjes së dëshmorit, invalidit të luftës, veteranit të luftës, martirit të luftës, me gjendje të rëndë sociale, student me aftësi të kufizuar, student i prindit ish i burgosur politik, duhet të sjellin dëshmitë nga shoqatat dhe institucionet përkatëse.

VI. FORMIMI I KOMISIONIT

Neni 13

- 13.1. Komisioni për ndarjen e bursave përbëhet nga 5 anëtarë.
- a) Dy anëtarë i zgjedh Kuvendi Komunal,
 - b) Dy anëtarë i emëron Kryetari i Komunës sipas detyrës zyrtare,
 - c) Një anëtarë ftohet nga përfaqësuesit e Studentëve (fillimisht nga unioni i studentëve në Prishtinë, deri në formimin e ndonjë organizate studentore në Komunën e Shtimes).
- 13.2. Në mbledhjen e Komisionit, vendosja për ndarjen e bursave bëhet me shumicën e thjeshtë të votave.
- 13.3. Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për çdo vit propozon në Kuvend zgjedhjen e Komisionin për Ndarjen e Bursave për student.
- 13.4. Komisioni zgjedh kryetarin e saj që udhëheq me punën e komisionit dhe nënshkruan vendimet e komisionit për ndarjen e bursave.
- 13.5. Detyrat e komisionit janë:
- a) të verifikoj afatshmërinë e aplikacioneve dhe kompletimin me dokumentet e kërkuara,
 - b) të bëjë vlerësimin me pikë të aplikuesve sipas kriterëve të parapara në këtë rregullore dhe përpilon listën prioritare,
 - c) të publikojë në afat prej 3 ditësh pune vendimin me emrat e përfituesve të bursës në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen zyrtare të komunës, pas miratimit nga drejtori i DAKRS-së.

VII. VLERESIMI I KUSHTEVE DHE KRITEREVE

Neni 14

- 14.1. Pas skadimit të afatit të konkurrimit, Komisioni do të bëjë vlerësimin e aplikacioneve
- 14.2. Komisioni gjatë procedurës së vlerësimit të aplikacioneve do të veprojë sipas nenit 9,
- 14.3. Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen,
- 14.4. Komisioni gjatë përzgjedhjes së përfituesve vendos në pajtueshmëri të plotë të gjithë anëtarëve.

Neni 15

- 15.1. Me studentët përfitues të bursës, do të lidhet kontrata, e cila do të nënshkruhet nga drejtori i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
- 15.2. Nëse brenda afatit prej 15 ditëve, nga dita e njoftimit të kandidatit përfitues të bursës, nuk nënshkruhet kontrata nga ana e studentit, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga bursa,
- 15.3. Me kontratë do të përcaktohet kohëzgjatja për të cilën jepet bursa, obligimet e përfituesit të bursës dhe kushtet e tjera.

Neni 16

- 16.1. E drejta për bursë i njihet studentit vetëm për një vit akademik, për ç'do vit akademik studenti është i obliguar të aplikojë.
- 16.2. Përfitues i bursës është i obliguar që çdo vit ta sjellë dëshminë se ka regjistruar semestrin dhe certifikatën e notave për vitin akademik që ka shfrytëzuar bursën,
- 16.3. Nëse përfituesi i bursës ndërron fakultetin, humb të drejtën në bursë.

VIII. PROCEDURA E PAGESES

Neni 17

17.1. Lartësia e bursës e përcaktuar në nenin 2, do t'ju alokohet në dy periudha të caktuara gjatë vitit në xhirollogaritë, pranë ndonjë banke komerciale, të cilën janë të obliguar që studentët ta hapin,

17.2. Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport do të kujdeset për alokimin e mjeteve me kohë.

IX. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 18

18.1. Kundër vendimit të komisionit mund të ushtrohet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimit për përfituesit e bursës, drejtuar Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa të Komunës së Shtimes.

18.2. Vendimi i komisionit të ankesave është përfundimtar në procedurë administrative.

X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 19

19.1. Kjo rregullore miratohet nga Kuvendi i Komunës së Shtimes sipas procedurave për miratimin e akteve normative.

19.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen sipas procedurave të njëjta për miratimin e saj.

19.3 Për Implementimin e kësaj rregulloreje, përgjegjëse është Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport pranë Kuvendit të Komunës së Shtimes.

XI. HYRJA NË FUQI

Neni 20

20.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja Komunale për ndarjen e Bursave për Studentë **01 Nr.06/570-60 Dt. 30.3.2012.**

20.2 Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi